

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
“DRAJ MOTORS” SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DRAJ MOTORS" SHPK

KREU I EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMRI I SHOQËRISE

1.1 Sot, në Tirane më date 15/12/2023 ne të nënshkruarit:

Danielo Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, më 05.05.1995, dhe mbajtes i kartes së identitetit me nr.personal. J50505110V

Donaldo Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, më 03.12.1997, dhe mbajtes i kartes së identitetit me nr.personal. J71203089G

Themelojmë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin,

"DRAJ MOTORS" Shpk (Më poshtë e quajtur "Shoqëria")

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:Tirane,Njesia bashkiake nr.2,Rruga Gramoz Pashko,Ndertesa nr.28, Kati i 1.

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHEZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjisacionit shqiptar, dhe në veçanti:



The image shows two handwritten signatures in blue ink, one above the other, positioned at the bottom right of the document. The signature on the left is larger and more prominent, while the one on the right is smaller and located below it. There is also a small number '2' written near the right signature.

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshëm qe mund te kryeje një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here dhe ne veçanti, por pa u kufizuar në:

Shitje me pakice te automjeteve te te gjitha llojeve, Import-Export i automjeteve te llojeve te ndryshme. Riparime dhe mirembajtje te automjeteve , dhenie me qira te automjeteve.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lek, i përbërë nga 2 (dy) kuota, e ndarë si më poshtë:

Danielo Ahmetaj person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 50% (pesedhjetepërqind) dhe vlerë 50,000 Lekë.

Donaldo Ahmetaj person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 50% (pesedhjetepërqind) dhe vlerë 50,000 Lekë.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteti të Shoqërisë.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, trashegimi, ose me çdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

6.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojë ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim.. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.

NENI 7 BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale



**KREU III
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**

**NENI 8
ORTAKËT**

8.1 Ortakët e shoqërisë janë:

Danielo Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, më 05.05.1995, dhe mbajtes i kartes së identitetit me nr.personal. J50505110V,

Donaldo Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, më 03.12.1997, dhe mbajtes i kartes së identitetit me nr.personal. J71203089G,

**NENI 9
ORGANET E SHOQERISE**

9.1 Organet e Shoqerise janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

**Neni 10
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithe ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.



4

**Neni 11
ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit finanziar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

**Neni 12
ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

**Neni 13
Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi**

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zotruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

**Neni 14
Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- percaktimin e politikave tregtare;
- ndryshimin e Statutit;



The image shows two handwritten signatures in blue ink. The signature on the left is enclosed in a large oval shape. To the right of the signatures is the number '5'.

- c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
 - d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
 - e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
 - h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
 - j) shperndarjen e fitimeve;
 - k) riorganzimin dhe prishjen e Shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
 - m) çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimit të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

NENI 15 FINANCIMI I SHOQËRISË

15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvèc rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejtë të kërkoje nga ortaket e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shpërbirim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administratorë si mëposhtë;

Danielo Ahmetaj, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, më 05.05.1995, dhe mbajtes i kartes së identitetit me nr.personal. J50505110V,

i cili emerohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratorët shkarkohet nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratorët veprojnë të ndarë dhe me kompetenca të pakufizuara, kompetencat dhe detyrat e tyre janë si mëposhtë:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe rapporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjeter i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperte kontabel te certifikuar dhe rapporti i llogaritareve publike te certifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;

16.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 17 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

17.1 Shpërbliimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaku i shoqerise.

KREU V KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 18 KONTROLI KONTABËL

18.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërcohët në baze të ligjit.

**NENI 19
VITI FINANCIAR**

19.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

**NENI 20
BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit finanziar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finanziar të mbyllur ne mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividenteve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijjimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 21
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

21.1 Në rastin e likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**NENI 22
NJOFTIMET**

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit per nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përsone të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

**KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**



**NENI 23
LIGJI I ZBATUESHËM**

23.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet ne 2 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga ortakët themelues, firmoset si me poshte prej tyre.

DANIELO AHMETAJ

Danielo Ahmetaj

DONALDO AHMETAJ

Donaldo Ahmetaj